



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0212

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “MEDPLUS” SH.P.K., kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të “KOMUNA E MAMUSHËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me material shpenzues per laborator dhe material shpenzues dentar” me numër të prokurimit 626-24-5207-1-2-1, me 16/05/2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “MEDPLUS” SH.P.K. me nr. 2025/0212, e datës 01/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me material shpenzues per laborator dhe material shpenzues dentar” me numër të prokurimit 626-24-5207-1-2-1.

2. **Anulohet** njoftimi mbi vendimin e AK, për Lot-1 dhe për Lot-2, AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit, të veproj konform arsyetimit të këtij vendimi.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “MEDPLUS” SH.P.K. konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30/05/2024, “KOMUNA E MAMUSHËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar” me nr. të prokurimit: 626-24-5207-1-2-1. Ndërsa me datën 12.03.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 70,000 €.

Me 17.03.2025, “MEDPLUS” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 20.03.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 01/04/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “MEDPLUS” SH.P.K., me nr. 2025/0212 për lidhur me aktivitetin “Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar” me nr. të prokurimit 626-24-5207-1-2-1.

Me 06.05.2025, është caktuar me autorizim Paneli Shqyrtues për shqyrtimin e kësaj lënde.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “MEDPLUS” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Sqarim: Ky tender është i ndarë në dy Lote Materialet shpenzuese për laborator nga Lot 1 dhe materialet shpenzuese dentare nga Lot 2.

Tenderi është anuluar për dy Lotet, pavarësisht që sqarimet janë kërkuar vetëm për Lot 1, ndërsa për Lot 2 nuk ka asnjë arsye të eliminimit e asgjë kontestuese, por për çudi AK-së në secilin veprim të tyre kanë bërë shkelje ligjore duke e anuluar edhe Lot 2 pa asnjë arsye dhe pa asnjë bazë ligjore.

Kronologji: Me dt. 29.07.2024 autoriteti kontraktues e kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e parë, ku në këtë vendim ishte anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se janë bërë lëshime në paramasë. Kundër këtij vendimi ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt. 02.08.2024, ndërsa AK-ja me dt. 05.08.2024 na kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar.

Pastaj ne kemi dorëzuar ankesën në OSHP me dt.14.08.2024, ndërsa në lidhje me ankesën tonë është nxjerr ekspertiza nga ekspertja shqyrtuese dhe vendimi i panelit shqyrtues me nr. 2024/0735. Në të dy rastet sikurse në ekspertizë edhe në vendim të panelit shqyrtues ankesa jonë ishte aprovuar si e bazuar dhe ishte detyruar autoriteti kontraktues që të anuloi vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lëndën ta kthej në rivlerësim.

Pas rivlerësimit me dt.04.12.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin si më poshtë, ndërsa ne jemi eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

Në lidhje me njoftimin e dt.04.12.2025 ne kemi parashtruar edhe ankesë në OSH me dt.20.12.2025 kurse ankesa jonë ishte aprovuar si e bazuar dhe lënda ishte kthyer ne rivlerësim me vendimin Nr. 2024/1244 të dt.07.02.2025.

Pra deri më tani kemi dy vendime të OSHP-së ku janë konfirmuar shkeljet ligjore që ka bërë AK-së.

Tani pas rivlerësimit, AK-së nxjerr njoftimin mbi vendimin me dt.12.03.2025 ku është anuluar përsëri aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se nuk ka oferta të përgjegjshme, ndërsa neve na është dërguar përsëri letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

Edhe nga kjo letër standarde për tenderues të eliminuar kuptohet qartë se AK-së me çdo kusht po bënë përpjekje për të na eliminuar dhe diskriminuar në këtë procedurë prokurimi, ku përdor lloj lloj arsyetime vetëm për të arritur tek anulimi i këtij tenderi, me qëllim që të iu jepet rast edhe njëherë kompanive të caktuara që favorizon AK-së.

Hulumtim i tregut nuk mund të quhet analizimi i ofertave nëpër tender siç pretendon komisioni i rivlerësimit por hulumtim i tregut është kur analizohet edhe çmimi sa e marrin kompanitë produktin dhe mallin në treg apo nga furnizues të caktuar, ndërsa ofertimi pastaj është çështje e brendshme e kompanive, ku disa mendojnë dhe planifikojnë të fitojnë më shumë e disa të tjera më pak apo varësisht prej politikave të kompanive, prandaj arsyeja e eliminimit është e pabazuar.

Sa i përket ofertave të komisionit vlerësues paraprak që është përmendur në letrën standarde për tenderues të eliminuar, sqarojmë se këtë arsyetim nuk e ka pranuar as OSHP-ja me vendimin Nr. 2024/1244 të dt.07.02.2025.

Në vendim është cekur qartë se nuk mund të jetë i mjaftueshëm vetëm krahasimi i çmimeve citohet: “Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me: ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

PSH këtë pretendim e kualifikon si pjesërisht të bazuar sepse ankuesi në ankesën e tij ka ofruar profatura për të cilat nuk janë dhënë shpjegime nga AK pse nuk janë të shpjegueshme dhe nuk është bërë një hulumtim i tregut, mbi bazën e këtyre atëherë PSH vendos që AK gjatë fazës së ri-vlerësimit të bëjë vetë një hulumtim të tregut duke u bazuar në prova dhe fakte të argumentuara dhe konform nenit 59 të LPP të bëjë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertës.

Kur kem parasysh këto konstatime të panelit shqyrtues, atëherë kuptohet qartë se AK-së nuk ka vepruar në harmoni të plotë me nenin 61 të LPP-së dhe nuk ka marr për bazë të gjitha elementet e përcaktuara në këtë dispozitë dhe kështu nuk ka mundur të argumentojë arsyen e eliminimit tonë.

Është i paqëndrueshëm konstatimi i AK-së, se ne nuk kemi ofruar sqarime bindëse dhe të bazuara në prova, pasi që me sqarimet e dt.14.11.2024 kemi ofruar profatura të cilat janë të lëshuara nga kompani furnizuese, e që dëshmojnë se ne mund të furnizohemi pa asnjë problem dhe mund ta implementojmë kontratën në fjalë.

E ashtuquajtura analizë e komisionit të rivlerësimit për artikujt Nr.28 duke konstatuar se oxygen concentrator 5L në treg kushton 380euro dhe duke kalkuluar pastaj transportin 20 %, TVSH 8%, lejen në agjencinë e barnave 1.5% dhe 10 % shpenzime tjera, është analizë e pa mbështetur në ndonjë provë konkrete.

Të njëjtat kalkulime i ka bërë edhe për artikullin nr.47.

E ashtuquajtura analizë që e ka bërë komisioni i rivlerësimit, nuk ka marr parasysh elementet përcaktuese të nenit 61 par. 2 të LPP-së, pasi që kompanitë që kanë bashkëpunim të vazhdueshëm me biznese dhe furnizues të tjerë iu ofrohen përparësi me çmime më të lira dhe kushte më të favorshme për produkte të caktuara, prandaj ne i kemi dëshmuar me pro fatura çmimet e furnizimit nga bashkëpunëtorë të ndryshëm, të cilët na kanë ofruar çmime të ndryshme për disa produkte varësisht prej rrethanave, mundësive, kushteve dhe mënyrës së bashkëpunimit që kemi me këto kompani, prandaj edhe për këtë arsye neni 61 par. 2 ka përcaktuar dhe lejuar elemente dhe mundësi të ndryshme për të marr parasysh me rastin e përcaktimit se a është çmimi ofertues jo normalisht i ultë apo jo.

Këto elemente dhe rrethana, autoriteti kontraktues nuk i ka marr parasysh dhe na ka eliminuar padrejtësisht nga kjo procedurë e prokurimit.

Veprimi kundërtënes i AK-së vërehet edhe tek arsyetja tjetër e cekur ku për artikujt 14, 15, 18 dhe 23 ka ofruar çmim tepër të lartë në krahasim me çmimet e tregut, mirëpo pa argumentuar se si e ka konsideruar këto çmime shumë të larta, prandaj edhe ky arsyetim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm.

Ne si kompani edhe në një tender tjetër na janë marr parasysh pro faturat, siç është tenderi “Furnizim me material shpenzues sanitar dhe barna per nevojat e QKMF-sePrizren Lot1“me nr. të prokurimit:"622-23-5623-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prizrenit.

Me vendimin e OSHP-së Nr. 2023/0789 të dt.22.12.2023, nga paneli shqyrtues është konstatuar si më poshtë:

Pra janë marr parasysh profaturat e ofruar nga dhe është përmendur rritja e sigurimit të ekzekutimit si çështje eventuale për siguri.

? Sa i përket arsyetimit se në bazë të vendimit të OSHP-së Nr.156/24 të dt.24.10.2024 se OE MedPlus Shpk është diskualifikuar nga pjesëmarrja në prokurim publik, e ku i referoheni Plotësim Ndryshimit të Rregullores për Prokurim Publik, sqarojmë se kjo procedurë e prokurimit është iniciuar 21.06.2024 dhe diskualifikimi merret parasysh me dispozitat e Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim publik e jo me plotësim ndryshimin e kësaj rregullore, prandaj kjo arsye është e pabazuar dhe e paqëndrueshme. RREGULLORJA NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK ka hy në fuqi me dt.11.11.2024 dhe zbatohet për procedura që kanë filluar pas kësaj date.

Nga të gjitha sqarimet që i paraqitem në këtë kërkesë për rishqyrtim, vërehet shumë qartë se arsyet e eliminimit për kompaninë tonë janë plotësisht të pabazuara, të paqëndrueshme, subjektive dhe tendencioze që me çdo kusht të eliminohemi nga ky tender dhe tendenca që të anulohet në tërësi ky tender me qëllim që më pastaj të favorizohen kompanitë që në këtë procedurë nuk kanë arritur ti plotësojnë kushtet dhe kriteret e dosjes së tenderit apo të cilët kanë bërë gabime të ndryshme në këtë procedurë.

Sa për sigurinë tuaj për përmbushje të kontratës, ne jemi në gjendje të pranojmë rritjen e sigurimit të ekzekutimit si garancion shtesë që kontratën e implementojmë me sigurinë më të madhe.

Vendimin për refuzim e kemi pranuar me dt.20.03.2025, e më të cilin vendim ne nuk pajtohemi.

Në vendimin për refuzim autoriteti kontraktues është përgjigjur se ne nuk kemi ofruar fatura me transaksione bankare por kemi ofruar pro fatura për të dëshmuar çmimet e kontestuar nga AK-së, mirëpo ne sqarojmë se askund në LPP nuk kërkohen fatura me transaksione bankare për të dëshmuar se mund të përmbushet kontrata.

Pro faturat janë të lëshuar nga kompanitë që na furnizojnë dhe janë dëshmi konkrete e te cilat dëshmi merren parasysh tek çdo sqarim dhe tek çdo autoritet kontraktues.

Sa i përket arsyes së AK-së se kanë hulumtuar tregun, sqarojmë se tregu nuk hulumtohet duke dhënë oferta OE por tregu hulumtohet se me çfarë çmime merren produktet nga prodhuesit apo furnizuesit, prandaj veprimi i AK-së nuk mund të quhet hulumtim i tregut

Nga dëshmitë që janë bashkëngjitur me vendimin për refuzim janë ofertat e kompanive për një tender e jo për më shumë tendera, prandaj kjo nuk mund të merret që është hulumtim i tregut por veprimi i AK-së është ndërmarr me qëllim që të na diskriminojë neve si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.

Siç kuptohet AK-së nuk i intereson ruajtja e buxhetit por i intereson favorizimi i kompanisë së caktuar, ndërsa parim themelor i LPP-së është ruajtja e parasë publike dhe shfrytëzimi fondeve në mënyrë me ekonomike dhe racionale.

Sa i përket faktit që Medplus ka qenë i diskualifikuar, është sqaruar më lartë nga ne kjo çështje, ndërsa interpretimi i AK-së në vendimin për refuzim është bërë sipas dëshirës së tyre, pasi që kjo arsye është plotësisht e pa bazuar.

Autoriteti kontraktues nuk mund të në eliminojë me arsyetimin se nuk janë bind komisioni sepse bindja është relative dhe mund të keqkuptohet e interpretohet sipas dëshirës së komisionit, mirëpo përveç këtyre dëshmive të ofruara si garanacion është edhe sigurimi i ekzekutimit, prandaj AK-së duhet të merr parasysh këtë fakt.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, e po ashtu nuk është respektuar fare neni 61 i LPP-së dhe neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Pra duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e kësaj dispozite, ndërsa ju sqarojmë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse ne jemi eliminuar dhe diskriminuar pa ndonjë bazë ligjore, duke mos na rekomanduar për kontratë.

Po ashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Bazuar në dispozitat ligjore, argumentet si dhe provat e bashkangjitura është vërtetuar se autoriteti kontraktues Neni 1 i LPP-së, Neni 6 i LPP-së, Neni 7 i LPP-së, Neni 59 i LPP-së, Neni 60 i LPP-së, Neni 61 i LPP-së, Neni 62 i LPP-së, Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, Neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, Vendimi panelit shqyrtues me nr. 2024/0735 dt.14.10.2024, Vendimi i panelit shqyrtues nr.2024/1244 dt.07.02.2024. Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr: VENDIM të APROVOHET, e bazuar ankesa e OE MEDPLUS SH.P.K dhe ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: - Operatori ekonomik “MEDPLUS” SH.P.K. nga Prishtina me datë 17.03.2025 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për anulim të procedurës së prokurimit nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: “Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar”

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 6; 7; 59; 60; 61 dhe 62 të LPP-s si dhe është cekur se janë shkelur dispozitat e neneve 40; 41 dhe 43 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP- s dhe rregullores, janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim.

Nga pretendimet e O.E. kemi parë që është fakt i pa kontestueshëm që me dt. 29.07.2024 autoriteti kontraktues e ka publikuar njoftimin mbi vendimin e parë, ku në këtë vendim ishte anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se janë bërë lëshime në paramasë. Kundër këtij vendimi O.E. kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt. 02.08.2024, ndërsa AK-ja me dt. 05.08.2024 e kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar.

Gjithashtu është fakt i pa kontestueshëm që pastaj O.E. ka dorëzuar ankesën në OSHP me dt. 14.08.2024, ndërsa në lidhje me ankesën O.E. është nxjerr ekspertiza nga ekspertja shqyrtuese dhe vendimi i panelit shqyrtues me nr. 2024/0735. Në të dy rastet sikurse në ekspertizë edhe në vendim të panelit shqyrtues ankesa e O.E. ishte aprovuar si e bazuar dhe ishte detyruar autoriteti kontraktues që të anuloi vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lëndën ta kthejë në rivlerësim.

Në bazë të vendimit të OSHP-s 2024/0735 me datë 15.10.2024 lënda është kthyer në ri-vlerësim të procedurës së prokurimit si dhe është formuar komisioni i ri për ri-vlerësim.

Gjithashtu është fakt i pa kontestueshëm që në lidhje me njoftimin e dt. 04.12.2025 O.E. Medplus SH.P.K. me datë 20.12.2024 kishte paraqitur ankesën Nr. 2024/1244 e cila me vendimin e OSHP-s Nr. 2024/1244 të dt. 07.02.2025 ishte aprovuar si pjesërisht e bazuar dhe lënda është kthyer në rivlerësim, me arsyetimin se Autoriteti Kontraktues nuk kishte hulumtuar tregun edhe përkundër se në shkresat e lëndës ekzistojnë dëshmitë për hulumtimin e tregut nga komisioni rivlerësues, duke u bazuar në nenin 61 të LPP-s dhe Rregulloren për Prokurimin Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika c dhe neni 41 Paragrafi 41.4

Në pretendimin e parë të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik ankues, është cekur se nga letra standarde për tenderues të eliminuar kuptohet qartë se AK-së me çdo kusht po bënë përpjekje për të na eliminuar dhe diskriminuar në këtë procedurë prokurimi, ku përdor lloj lloj arsyetime vetëm për të arritur tek anulimi i këtij tenderi, me qëllim që të iu jepet rast edhe njëherë kompanive të caktuara që favorizon AK-së. Hulumtim i tregut nuk mund të quhet analizimi i ofertave nëpër tender siç pretendon komisioni i rivlerësimit por hulumtim i tregut është kur analizohet edhe çmimi sa e marrin kompanitë produktin dhe mallin në treg apo nga furnizuese të caktuara, ndërsa ofertimi pastaj është çështje e brendshme e kompanive, ku disa mendojnë dhe planifikojnë të fitojnë më shumë e disa të tjera më pak apo varësisht prej politikave të kompanive, prandaj arsyeja e eliminimit është e pabazuar.

Mirëpo nga shkresat e lëndës vërtetohet që me datën 05.11.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi AK Komuna e Mamushës ka kërkuar sqarim nga O.E. Konti SHPK dhe MEDPLUS SHPK në lidhje me pozicionet 8; 14; 15; 23; 28 dhe 47 pasi që për të njëjtët artikuj njëri kishte ofruar çmime për kuti ndërsa tjetri për copë. Nga Konti SHPK nuk kemi pranuar përgjigje ndërsa nga MEDPLUS SHPK përmes platformës elektronike me datë 07.11.2024 brenda afatit të kërkuar kemi pranuar përgjigjen për sqarimin e tenderit.

Pas analizimit të çmimeve edhe nga komisioni i ri-vlerësimit të dytë, duke u bazuar në nenin 40 paragrafi 40.2.1 të Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, komisioni për rivlerësim për herë të dytë, shqyrtoi përgjigjen e O.E. MEDPLUS SHPK dhe duke u bazuar në nenin 61 të LPP-s, Rregullores për Prokurimin Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika c dhe neni 41 Paragrafi 41.4 ka konstatuar që çmimet e ofruara nga O.E MEDPLUS SHPK janë çmime manipulative pasi që në disa pozicione kishte vendosur çmime jo normalisht të ulëta si dhe në disa pozicione tjera, kishte vendosur çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Andaj komision shqyrtoi letrën standarde për sqarimin e tenderit jo normalisht të ulët të datës 12.11.2024 përmes së cilës AK ka kërkuar nga O.E. MEDPLUS SHPK që të na jep sqarim në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta të paraqitura në pozicionet e përshkrimit të çmimit, duke saktësuar ekonominë e procesit të furnizimit, çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicionin e tyre për të kryer furnizimet dhe shërbimet e paraqitura në paramasën për procedurën e prokurimit në fjalë. Gjithashtu kemi kërkuar të na jep informata shtesë mbi koston e furnizimeve dhe shërbimeve të propozuara, pasi që komisioni i ri-vlerësimit duke u bazuar në dispozitat e lartëcekura për tenderët jo-normalisht të ulët, ka konstatuar se O.E. ankues kishte ofruar çmime jo-normalisht të ulëta sipas pozicioneve të përshkruara në çmimore (paramasë), ndërsa në disa artikuj kishte vendosur çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Nga kërkesa për sqarimin e tenderit jo normalisht të ulët është kërkuar nga O.E. Medplus SH.P.K. që të na dërgojnë informatat në lidhje me pozicionet e më poshtme të cilat i kemi ndarë në çmime jo normalisht të ulëta dhe në çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Çmimet jo normalisht të ulëta:

Pjesa A. Pozicionet: 7, 19, 28 dhe 47.

Çmimet tepër të larta:

Pjesa A. Pozicionet: 14, 15, 18 dhe 23.

Gjithashtu me qëllim të vlerësimit të drejtë të tenderit të O.E. kemi kërkuar që së bashku me informatat të na dërgon referencat në të cilat është bazuar me rastin e vendosjes së çmimeve si dhe si dëshmi të na dërgon kopje të faturave së bashku me transfer bankar apo të kontratave në të cilat evidentohen artikujt e lartcekur.

Operatori Ekonomik MEDPLUS SHPK me datën 14.1.2024 përmes platformës elektronike ka dorëzuar përgjigjen në kërkesën për sqarim, mirëpo nuk kishte ofruar kurrfarë sqarim në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta të paraqitura në pozicionet e përshkrimit të çmimit. Nuk kishte ofruar informatat e kërkuara duke saktësuar ekonominë e procesit të furnizimit, çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicionin e O.E. për të kryer furnizimet e paraqitura në paramasën për procedurën e prokurimit në fjalë. Por si referencë ka ofruar dy pro-fatura në të cilat është bazuar me rastin e vendosjes së çmimeve, mirëpo nuk dërgon tek AK dëshmi të kopjeve të faturave së bashku me transfer bankar apo të kontratave në të cilat evidentohen artikujt e lartcekur, pasi që pro-fatura është dokument i cili nuk regjistrohet në librat financiar, për këtë arsye nuk ka datë të fiksuar dhe e njëjta, mund të ndryshohet në çdo moment sipas kërkesës së O.E.

Andaj komisioni i rivlerësimit për herë të dytë duke u bazuar në nenin 61 të LPP-s Rregullores për Prokurimin Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika c dhe neni 41 Paragrafët 41.8 dhe 41.10 pika b) ka konstatuar që Operatori Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. ka ofruar tender jo normalisht të ulët pasi që i ka përmbushur të gjitha kushtet e parapara në nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik për tu cilësuar si tender jo normalisht i ulët. Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura komisioni ri-vlerësues ka rekomanduar që këtij O.E. ti refuzohet tenderi edhe përkundër që ka ofruar tenderin me çmimin më të ulët, sepse nuk ka arritur që të ofroj prova dhe të bind komisionin në lidhje me sqarimin për çmime jo normalisht të ulëta, ndërsa për disa artikuj ka ofruar çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Edhe komisioni i dytë për rivlerësim i krijuar pas vendimit të OSHP-s Nr. 2024/1244 të dt. 07.02.2025 gjatë vlerësimit të tenderit për f i krahasuar çmimet dhe për të vlerësuar tenderin drejtë, duke u bazuar në vendimin e OSHP-s të lartcekur ka hulumtuar tregun në lidhje me artikujt e lartcekur si dhe ka analizuar përgjigjen e O.E. Medplus SH.P.K. në lidhje me tenderin jo normalisht të ulët nga e cila është konstatuar që O.E. kishte ofruar vetëm profaturë dhe nuk kishte ofruar sqarime në lidhje ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara; çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ose origjinalitetin e furnizimeve të propozuara.

Përsëri nga platforma elektronike e prokurimit kemi përzgjedhur disa O.E, të cilët kanë kryer aktivitete të ngjashme të prokurimit nga të cilët kemi kërkuar që në kuadër të hulumtimit të tregut të na japin ofertat e

tyre dhe me këtë rast tre (3) prej tyre kanë ofruar ofertat e tyre. Pasi që komisioni për rivlerësim ka pranuar tri (3) oferta të rcja si dhe ka analizuar edhe ofertat të cilat i kishte pranuar komisioni paraprak i vlerësimit si dhe pas analizimit dhe krahasimit të çmimeve, komisioni ka konstatuar që O.E. MEDPLUS SH.P.K. ka ofruar çmime manipulative në tenderin e tij.

Duke i krahasuar çmimet e tregut me çmimet e ofruara nga O.E. Mdcplus SH.P.K. komisioni për rivlerësim, bëri analizën e çmimit dhe vërejti që në artikujt me nr.7 ASAT GPT - 4x250 ml për një pako kishte ofruar çmimin 2.85 € ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i këtij artikulli sillet prej 22.00 deri në 175.00 euro. Për artikullin me nr. 19. kishte ofruar çmimin 0.42 € për një kuti ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i këtij artikulli sillet prej 5.00 deri në 25.00 euro. Për pajisjen e paraparë në artikullin me nr. 28 Oksigjen koncentrator 5 L kishte ofruar çmimin 1.50 € ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i kësaj pajisje sillet prej 400.00 deri në 800.00 euro. Për artikullin me nr. 47 kishte ofruar çmimin 0.13 € për një kuti ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i këtij artikulli sillet prej 1.0 deri në 10.00 euro. Pra për të gjitha këta artikuj nga komisioni i ri-vlerësimit është konstatuar që janë vendosur çmime jo normalisht të ulëta.

Ndërsa për artikullin me nr. 14. kishte ofruar çmimin 0.06 € për një copë që duke e shumëzuar me 1,000.00 pipeta na jep shumën $1,000.00 \times 0.06 = 60$ € ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i këtij artikulli sillet prej 6.00 deri në 12.00 euro. Për artikullin me nr. 15. kishte ofruar çmimin 0.07 € për një copë që duke e shumëzuar me 500.00 pipeta na jep shumën: $500.00 \times 0.07 = 35$ € ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i këtij artikulli sillet prej 8.00 deri në 12.00 euro. Për artikullin me nr. 23. kishte ofruar çmimin 0.26 € për një copë që duke e shumëzuar me 25.00 lancet na jep shumën: $25.00 \times 0.26 = 6.5$ € ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i këtij artikulli sillet prej 2.00 deri në 8.00 euro. Pra për këta artikuj nga komisioni i ri-vlerësimit është konstatuar që janë vendosur çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Prandaj duke marrë parasysh se shpjegimi i O.E. nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe bindës, si dhe O.E. nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara kopjeve të faturave së bashku me transfer bankar apo të kontratave në të cilat evidentohen artikujt për çmimet e ofruara , si dhe duke pasur parasysh se ka ofruar çmime manipulative, tenderi i është refuzuar.

Më poshtë janë bashkangjitur ofertat për artikujt e lartcekur nga të cilat shihen konstatimet e komisionit ri-vlerësues.

Sa i përket pretendimit që komisioni i vlerësimit me rastin e analizimit të çmimit për artikujt 28 dhe 47 nuk është i mbështetur në prova, konstatojmë që edhe ky pretendim është i pa bazuar pasi që komisioni i vlerësimit kishte bërë hulumtim të tregut në internet dhe ka pranuar oferta për artikujt e njëjtë, kurse nga hulumtimet ka dalë se çmimi mesatar i tregut për furnizim me oxygen koncentrator 5L është 380 euro, ndërsa transportin 20 % i vlerës së çmimit, TVSH 8%, leja në agjencinë e barnave 1.5% dhe 10 % shpenzime tjera, janë fakte botërisht të ditura si dhe të bazuara në legjislacionin e Kosovës. Por çmimi i ofruar nga O.E. ankues i cili është mbi 200 herë më i ulët se çmimi i tregut, nuk ka si të cilësohet ndryshe pos jo normalisht i ulët. Prandaj edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër në lidhje me faktin që Operatori Ekonomik Medplus SH.P.K. në bazë të vendimit të OSHP-s PSH nr. / 56/24 të datës 24.10.2024 është diskualifikuar nga pjesëmarrja në prokurimin publik nga data 24.10.2024 deri 23.04.2025 për shkak të falsifikimit të dokumenteve, si dhe me pretendimin që për shkak që procedura e prokurimit është publikuar me 21.06.2024 duhet që

diskualifikimi të merret parasysh me dispozitat e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik edhe ky pretendim është i pa bazuar pasi që kjo rregullore është ndryshuar me rregulloren nr. 002/2024.

Në bazë të nenit 37 të Rregullores 002/2024 është ndryshuar neni 67 si dhe në bazë të nenit 63 është ndryshuar neni 102 në të cilën shprehimisht është përcaktuar që: Citat “67.9 Në rast se OSHP nxjerr një vendim për diskualifikim të një operatori ekonomik nga pjesëmarrja në prokurimin publik prej datës së vendimit. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, “Pjesëmarrja në prokurim publik” është një proces që përfshin tërë ciklin nga njoftimi, aplikimi, përfshirë edhe çfarëdo kundërshtimi apo ankese, deri te vendimi për dhënie të kontratës, rrjedhimisht pamundëson çfarëdo veprimi që Operatori Ekonomik mund të ndërmerr përgjatë tërë procesit të prokurimit prej fazës së publikimit të njoftimit për kontratë deri në momentin e nënshkrimit të kontratës, përfshirë edhe parashtrimin e ankesave. Ky përjashtim vlen për të gjitha llojet e kontratave dhe për të gjitha procedurat e prokurimit.” Fund i citatit.

Pra sikur shihet nga kjo dispozitë ligjore përjashtimi vlen për të gjitha llojet e kontratave dhe për të gjitha procedurat e prokurimit pa përjashtuar ato të cilat kanë qenë të iniciuara para hyrjes në fuqi të rregullores 002/2024.

Gjithashtu me nenin 63 të Rregullores 002/2024 për Prokurimin Publik, është ndryshuar neni 102 i Rregullores nr. 001/2022 me të cilin është shfuqizuar opinionin i KRPP-së mc nr . 8. i dt. 22.11.2022 i përmendur dhe i vendosur ne pretendimin paraprak i cili opinion ishte shfuqizuar ine hyrjen në fuqi të plotësim ndryshimit të rregullores nr 001/2022 për prokurim publik te datës 11.11.2024. Pra mc shfuqizimin e opinionit nr . 8. i dt. 22.11.2022 ka mbetur në fuqi vetëm dispozita e nenit 67.9 e cila parasheh që në rast se OSHP nxjerr një vendim për diskualifikim të një operatori ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik, atëherë OE i diskualifikuar, nuk ka të drejtë të merr pjesë në prokurimin publik, prej datës së vendimit. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, “Pjesëmarrja në prokurim publik” është një proces që përfshin tërë ciklin nga njoftimi, aplikimi, përfshirë edhe çfarëdo kundërshtimi apo ankese, deri te vendimi për dhënie të kontratës.

Rrjedhimisht kjo dispozitë pamundëson çfarëdo veprimi që Operatori Ekonomik i cili gjendet në listën e zezë të mund të ndërmerr përgjatë tërë procesit të prokurimit prej fazës së publikimit të njoftimit për kontratë deri në momentin e nënshkrimit të kontratës, përfshirë edhe parashtrimin e ankesave. Ky përjashtim vlen për të gjitha llojet e kontratave dhe për të gjitha procedurat e prokurimit.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë pasi që ne, të gjithë pjesëmarrësit i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë pa kurrfarë diskriminimi dhe procedurën e hapur për prokurimin në tjalë e kemi udhëhequr në mënyrë transparente në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi.

Gjithashtu të gjitha dokumentet e procedurës janë ngarkuar në platformën e-prokurimi dhe në ueb-faqe të Komunës së Mamushës, andaj është për tu habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente!

Sikur shihet në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ana e O.E. ankues, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo fakt të vetëm i cili do të dëshmonte shkelje të dispozitave të lartcekura, andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Operatori Ekonomik ankues ka pretenduar se janë shkelur edhe dispozitat e nenit I të LPP-së. Edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm, pasi që ne si Autoritet Kontraktues i kemi respektuar të gjitha

dispozitat ligjore të legjislacionit të Prokurimit Publik. Për tu siguruar që kjo procedurë të zhvillohet në mënyrën më efikase. Pra qëllimi i LPP-s është që të mbrohet buxheti i shtetit duke siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës. Ndërsa sikur është cekur më lartë O.E. ka ofruar çmime manipulativë, andaj ne kemi mbrojtur buxhetin e shtetit.

Më tej O.E. ankues pretendon që janë shkelur edhe dispozitat e nenit 59 të LPP-s për shkak që sipas O.E. ankues, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë Çmimi më i ulët me peshim, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu O.E. ka pretenduar që anulimi është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-s dhe nenin 43.5 dhe 43.7 i rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Nuk pajtohem që janë shkelur këto dispozita të LPP-së pasi që nuk janë relevante me rastin tonë sepse nuk e kemi rekomanduar për kontratë asnjë Operator Ekonomik por e kemi anuluar tenderin në përshtatje me nenin 43.5 pika b. të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, për shkak se nuk ka pasur tenderues të përgjegjshëm.

Sa i përket dëmtimeve materiale për të cilat O.E. pretendon se i janë shkaktuar 5,000.00 € edhe këtu O.E. është munduar që të manipulojë pasi që ky O.E. tanimë është vërtetuar që është manipulues sepse është vendosur edhe në listën e zezë të OSHP-s për shkak të falsifikimit të dokumenteve e cila mund të verifikohet në faqen e OSHP-s tek lista e zezë e O.E.-ve dhe mund të verifikohet në linkun:

<https://oshp.rks-gov.net/sq/Reports/ComplaintByBlackList?page=2&ReasonId=00000000-0000-0000-0000-000000000000&BlackListStatusId=00000000-0000-0000-0000-000000000000>

Gjithashtu në dosje të tenderit shprehimisht është cekur se AK nuk i mbulon shpenzimet të cilat i bëjnë tenderuesit me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të tenderit të tyre si dhe me rastin e anulimit të procedurës së prokurimit. O.E. ankues ka paraqitur si shpenzim shërbimet e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës si dhe për kërkesën për rishqyrtim me ç'rast ka deklaruar se ka pasur një dëm enorm pa paraqitur asnjë fakt se si janë shkaktuar këto dëme materiale. Pra edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 02.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0212/25, ndërsa me datë 14.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0212 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si pjesërisht e bazuar, ndërsa Vendimi i AK-së për Lot-1 të mbetet në fuqi (ndërsa për Lot-2, AK duhet të sqarojë arsyen e anulimit të këtij Loti).

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, dhe po ashtu OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.-

Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “MEDPLUS” SH.P.K.,- eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0212 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: OE ankues për herë të tretë ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së sa i përket këtij aktiviteti të prokurimit. Pretendimet e ngritura janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues dhe i njëjti sipas mendimit të tij ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: “Pas rivlerësimit me dt.04.12.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se nuk ka pasur asnjë operator ekonomik të përgjegjshëm, ndërsa ne jemi eliminuar me arsyetimin se jemi konsideruar si tender me çmime jo-normalisht të ulëta. Deri tani ka dy vendime të OSHP-së të cilat kanë konfirmuar shkeljet ligjore të AK-së dhe tani pas rivlerësimit AK përsëri ka anuluar këtë aktivitet. AK me çdo kusht bënë përpjekje të na eliminoj nga kjo procedurë ku si hulumtim të tregut ka marrë analizimin e ofertave nëpër tender, ku hulumtimi bëhet duke analizuar çmimin e mallit në treg apo marrja e mallit nga furnizuesi i caktuar. Ne kemi ofruar pro fatura përmes të cilave sigurojmë që mund të furnizohemi me këto çmime të cilat i kemi ofruar dhe mund të realizojmë kontratën.”

Eksperti shqyrtues sqaron që pas kthimit të lëndës në rivlerësim, AK potencon se komisioni i ri-vlerësimit ka bërë hulumtimin e tregut për çmimet e produkteve të kërkuara duke marrë tre oferta të reja nga operatorët ekonomik të përzgjedhur nga platforma elektronike e prokurimit për pozicionet në fjalë për të cilat është kërkuar sqarim si dhe ka shqyrtuar edhe dy oferta të cilat i ka marrë komisioni paraprak me rastin e hulumtimit të tregut dhe në bazë të këtyre ofertave sipas AK-së është parë se OE ankues ka ofruar tender jo-normalisht të ulët dhe se ky operator nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara sipas kërkesës për sqarim të tenderit jo-normalisht të ulët.

Pra, AK ka zgjedhur që të bëjë hulumtimin e tregut për çmimet e produkteve të caktuara duke marrë oferta të ndryshme nga operator të ndryshëm ekonomik, që sipas ekspertit është një metodë e arsyeshme për hulumtimin e tregut por që normalisht do të ishte edhe më mirë që të kombinohej edhe me metoda të tjera duke marrë oferta edhe direkt nga furnizuesit, megjithatë AK ka vepruar sipas vendimit të Panelit Shqyrtues me nr. 1244/24, ku nga AK është kërkuar që të bëjë hulumtimin e tregut për çmimet e ofruara si dhe të arsyetoj nëse sqarimet e dhëna nga OE ankues kanë qenë apo nuk kanë qenë të mjaftueshme sa për të bindur AK-në se mund të realizohet kontrata me çmimet e ofruara.

Sipas nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të RRPP-së, kur kemi të bëjmë me tenderët jo-normalisht të ulët kur përmbushen tre kushtet sipas pikës 41.3 të RRPP-së apo kur një tender duket të jetë jo-normalisht i ulët, AK ka të drejtë që përmes një kërkeje me shkrim të kërkoj nga operatori që të dorëzoj shpjegime në lidhje me bazën e tenderit dhe rrethanat e tjera dhe nëse AK nuk bindet mjaftueshëm se mund të realizohet kjo kontratë në ato kushte, atëherë AK ka të drejtë të refuzoj tenderin, në të kundërtën nëse

sqarimi është i mjaftueshëm atëherë AK do t'a trajtoj edhe këtë tender njësoj me tenderët e tjerë. Nga sqarimet që ka bërë AK në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar shihet se AK nuk është bindur mjaftueshëm me sqarimet të cilat i ka dhënë OE ankues. Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues, nga hulumtimi të cilin e ka bërë AK dhe përgjigjet të cilat i ka dhënë eksperti teknik në raportin e fundit me nr. 1244/24, konsiderojmë që Pro-Faturat e dorëzuara nuk janë si dëshmi e mjaftueshme për të bindur AK-në dhe ekspertin se një kontratë e tillë mund të realizohet. Eksperti konsideron që për të ofruar dëshmi bindëse atëherë këto pro-fatura do të duhej të mbështeteshin edhe me dëshmi shtesë siç janë transaksionet bankare apo dëshmi të tjera të realizimit real të këtyre pagesave të cilat sipas mendimit të ekspertit do të ishin dëshmi e mjaftueshme për të bindur AK-në se kontrata me çmimet e ofruara është lehtësisht e realizueshme. Në këtë pikë, nga hulumtimi i bërë eksperti sipas mendimit të tij nuk mund të konsideroj që vetëm pro-faturat mund të jenë dëshmi e mjaftueshme për të sqaruar këtë situatë.

Sa i përket arsyetimit se OE ankues me vendimin e OSHP-së nr. 156/24 të dt. 24/10/2024 është diskualifikuar nga pjesëmarrja në prokurimin publik, eksperti shqyrtues sqaron që sipas plotësim/ndryshimit të kësaj rregullore diskualifikimi në secilën fazë vlenë për ato aktivitet të cilat zhvillohen që nga hyrja në fuqi e këtij plotësim/ndryshimi. Duke marrë parasysh që ky aktivitet i prokurimit është iniciuar në muajin qershor të vitit të kaluar atëherë për këtë aktivitet nuk mund të themi se vlenë rregullorja e re e prokurimit publik me plotësim/ndryshimet e bëra.

Nga sqarimet e dhëna më sipër konsiderojmë që AK nuk ka vepruar në kundërshtim me nenet 62 të LPP-së dhe 43 të RRPP-së për Lot-1 dhe se vlerësojmë që pretendimet e ngritura nga OE ankues janë pjesërisht të bazuara.

Sqarimet e bëra më lartë vlejné sa i përket pretendimeve të ngritura të cilat kanë të bëjnë vetëm me Lot-1 andaj edhe eksperti sipas pretendimeve të ngritura ka dhënë përgjigje për këto pretendime, ndërsa për Lot-2 nga ana e OE ankues nuk është ngritur ndonjë pretendim ankimor dhe po ashtu edhe nga ana e AK-së nuk është dhënë asnjë sqarim se përse OE ankues nuk i ka plotësuar kriteret për këtë Lot dhe pse duhet të anulohet edhe Lot-2, andaj në këtë pikë kur Njoftimi mbi Vendimin e AK-së e anulon në tërësi aktivitetin e prokurimit duke përfshirë edhe Lot-2 pa dhënë sqarime konkrete konsiderojmë që nuk është në përputhje me dispozitat ligjore.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se rekomandimi për LOT 1 në raportin e ekspertit shqyrtues, nuk gjene mbështetje nga ana e këtij paneli. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur besimin në tërësi raportit të ekspertit shqyrtues sa i përket rekomandimit për LOT 1, ndërsa, ja fal besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimit të ekspertit shqyrtues për LOT 2.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli Shqyrtues nuk e mbështet në tërësi në këtë rast rekomandimin e ekspertit shqyrtues vetëm për LOT 1 ngase evidenton se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë nxjerr edhe dy vendime

paraprake me nr. 2024/0735 dhe nr. 2024/1244, andaj, Paneli Shqyrtues në mbështetje të nenit 1 të LPP për këtë paneli shqyrtues nuk ka si mos ta trajtoj ndryshme përveç si çështje e gjykuar, konform nenit 105, paragrafi 2.16 të LPP, citat: "Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata".

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe e mjaftueshme që aktivitetin e prokurimit ta kthej sërish në ri-vlerësim. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi vendimin e AK të Autoritetit Kontraktues – "Komuna e Mamushës" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me material shpenzues per laborator dhe material shpenzues dentar" me nr. të prokurimit: 626-24-5207-1-2-1 dhe lëndën ta kthej në ri-vlerësim për LOT 1 dhe LOT 2.

Për arsye se hulumtimi i tregut vetëm duke marrë oferta të ndryshme nga operator ekonomik mund të jetë tendencioz dhe ka mundësi që mos të ketë një vlerësim dhe hulumtim objektiv dhe real të tregut, andaj, AK gjatë fazës së ri-vlerësim të bëjë një hulumtim të tregut duke kombinuar edhe metoda tjera duke marrë oferta edhe nga furnizuesit direkt ashtu sikurse e ka theksuar edhe eksperti shqyrtues i lëndës.

AK konform nenit 63 të LPP dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, me rastin e nënshkrimit të kontratës, AK ka mundësi që për të siguruar që ti mbuloj dëmet dhe shpenzimet që mund të ndodhin në rast të shkeljes, ndërprerjes eventuale të kontratës nga kontraktuesi, mund ti parashih dhe ti kalkuloj shpenzimet e mundshme dhe për aq ta rris përqindjen dhe shumën e sigurimit të ekzekutimit.

Ndërsa, konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për LOT 2, gjejnë mbështetje të plotë nga ana e këtij Paneli Shqyrtues, ngase, mungon arsyeshmëria e anulimit të këtij LOT dhe mungon arsyeja e eliminimit të këtij ankuesi.

Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se "*Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik*". Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonësive të paarsyeshme.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim përveç nenit 1 dhe 6 mes tjerash edhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të

një personi ose ndërmarrje tjetër.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E MAMUSHËS**
- **OE - MEDPLUS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: